



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT FIER

Nr. _____ Prot.

Fier, më 03.09.2024

Lënda: Formulari i njoftimit paraprak të operatoreve ekonomike te sukseshem për proceduren me objekt **“Blerje produkte ushqimore për kopshtet, çerdhet, konviktin dhe shkollen Horizont” per vitin 2024, me 5 Lote ,Marreveshje Kuader me nje operator ekonomik fitues, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 muaj,** me burim financimi nga Buxheti i Qendres Ekonomike te Arsimit Fier

Loti 3: Blerje bukë

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
TIRANË
(për botim)

Shtojca 12

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT FIER

Data: 03.09.2024

Drejtuar: Operatorit ekonomik 4 S SHPK

Adresa: Fier Lushnje LUSHNJE Lagjja Xhevdet Nepravishta, Rruga Qerim Arapi, Zona Kadastrale 8571, Godina 196, Pasuria nr.23/104-N4.

NUIS: L64425401K

*** * ***

Procedura e prokurimit: **E Hapur - Mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike** me objekt **“Blerje produkte ushqimore për kopshtet, çerdhet, konviktin dhe shkollen Horizont” per vitin 2024, me 5 Lote, Loti 3: Blerje bukë .(Marrëveshje Kuadër me 1 (një) operator ekonomik fitues – ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 12 muaj).**

Numri i referencës së procedurës / lotit: **REF-06666-05-27-2024.**

Loti 3: Blerje bukë

REF-06681-05-27-2024.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje produkte ushqimore për kopshtet, çerdhet, konviktin dhe shkollën Horizont” per vitin 2024, me 5 Lote, Loti 3: Blerje bukë**, me fond limit/vlera e pritshme e kontratave prej **5 871 067,58** (pesë milion e teteqind e shtatedhjetë e një mijë e gjashtëdhjetë e shtate presje pesedhjetë e tete) **lekë pa TVSH**, me burim financimi nga Buxheti i Qendres Ekonomike te Arsimit Fier në perputhje me preventivat, sasitë, specifikimet teknike, termat e references dhe kushtet e përcaktuara në DST.

Afati kohor per ekzekutimin e kontratës: **12 (dymbëdhjetë) muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [22 Korrik 2024], [Numri 40].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **PO**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kane marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vleren përkatëse të ofruar:

- Ofertuesi 3 - SH SHPK me NUIS K62721401R - Vlera sipas ofertës është 4.693.668 (katër milion gjashtëqind nentëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH- afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
- Ofertuesi 4 S SHPK me NUIS L64425401K- Vlera sipas ofertës është 4,403,310 (katër milionë e katërqind e tre mijë e treqind e dhjetë) lekë pa TVSH- afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
- Ofertuesi K A D R A SHPK me NUIS K31321008J - Vlera sipas ofertës është 4 804 686,20 (katër milion e tetëqind e katër mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë njëzet) lekë pa TVSH- afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

Nga pjesëmarrësit jane skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës 3 - SH SHPK me NUIS K62721401R, konstatoi mangësit si më poshtë:

- Referuar Shtojcës 8, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, Pjesa II “Shkaqet e përjashtimit”, “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, në pikën 3, kërkohet:

“Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.”

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të ngarkuar në SPE nga OE 3 - SH SHPK, konstatoi se nuk është plotësuar me të gjithë të dhënat e duhura në përmbushje të kriterit ku ofertuesi deklaroi personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së”.

- **Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik”, në pikën 2.3.2 kërkohet:** *” Operatori ekonomik të paraqesë liçence nga Qendra Kombëtare e Liçencimit Kategoria II.1.A.1 – “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” per objektin e prokurimit për prodhimin ose tregtimin e bukës. (Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).”*

Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur Licencë nr. LN-9859-07-2015, me datë lëshimi 2015-07-13, kod II.1.A.1, lëshuar nga QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT, ku emërtimi përshkruet i veprimtarisë është: *“Përpunim, paketim, etiketim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Fruta të thata, niseshte, fasule, oriz, miell, vaj, makarona)”*.

Referuar kriterit 2.3.2 rezulton që kjo licencë nuk e përmban objektin e prokurimit për prodhimin ose tregtimin e bukës.

- Referuar Shtojcës 7 të DST-së përcaktohet se ***Operatoret ekonomike të cilat do të paraqesin ofertat/ konkurrojnë për me shumë se një lot, duhet të plotësojnë kriteret e veçanta, xhiron vjetore sipas pikës 2.2.2., dhe përvojën e ngjashme sipas pikës 2.3.1. si shumë të loteve për të cilat konkurrojnë.***

Operatori ekonomik 3 – SH SHPK rezulton të ketë ofertuar në tre lote. Konkretisht:

-Loti 1: “Blerje bulmeti dhe nënproduktet e tij” ku sipas pikës 2.3.1 kerkohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se 9 000 000 leke pa TVSH (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet – për Lotin 1), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.”

-Loti 3: “Blerje bukë” ku sipas pikës 2.3.1 kerkohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se 1 000 000 leke pa TVSH (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet – për Lotin 3), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.”

-Loti 4: “Blerje ushqime koloniale” ku sipas pikës 2.3.1 kerkohe: “Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se **4 000 000 leke pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet – **për Lotin 4**), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.”

Në përmbushje të këtij kriteri OE 3 - SH SHPK ka ngarkuar në SPE fatura vlera e të cilave nuk e arrin shumën e loteve për të cilat ky operator ka konkurruar.

*** * ***

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **4 S SHPK**, me NUIS: **L64425401K**, me adrese: Fier Lushnje LUSHNJE Lagjja Xhevdet Nepravishta, Rruga Qerim Arapi, Zona Kadastrale 8571, Godina 196, Pasuria nr.23/104-N4, **për prokurimin me objekt Loti 3: Blerje bukë, me vlerë totale të ofertës prej 4,403,310 (katër milionë e katërqind e tre mijë e treqind e dhjetë) lekë pa TVSH dhe 5 283 972 (pesë milion e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e nentëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë me TVSH**, se është identifikuar si fitues paraprak i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi sipas përcaktimeve në nenin 110 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, fillojnë afatet e ankimit.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Elisabeta IKONOMI